Kronikë

Tiranë/ 2 efektivë policie gjejnë një pistoletë tip 'TT' në makinën e shërbimit! Dyshohet se mund ta ketë fshehur një person i shoqëruar

Një efektive e patrullës në Komisariatin nr. 1 në Tiranë së bashku me kolegun e saj, mbrëmjen e së mërkurës, kanë gjetur një armë zjarri brenda automjetit të shërbimit. Punonjësja ka humbur një send personal dhe ka kërkuar së bashku me kolegun mjetin, me synim për ta gjetur

Foto ilustruese

Sokol Dema
21 Shtator, 08:59 | **Përditësimi: 21 Shtator, 10:02**

Share

Një efektive e patrullës në Komisariatin nr. 1 në Tiranë së bashku me kolegun e saj, mbrëmjen e së mërkurës (20 shtator), kanë gjetur një armë zjarri brenda automjetit të shërbimit. Punonjësja ka humbur një send personal dhe ka kërkuar së bashku me kolegun mjetin, me synim për ta gjetur.

Në pjesën e poshtme të sediljes së pasagjerit kanë gjetur një çantë të zezë meshkujsh të mbuluar me pluhur, e cila mund të ketë qenë aty prej disa kohësh. Pasi e hapën, brenda saj kanë gjetur një pistoletë TT. Arma është dërguar në Laboratorin e Policisë Shkencore për ekspertizë dhe shenja gishtash. Dyshimet e para janë se arma mund të jetë lënë nga ndonjë person i shoqëruar që ka qenë i armatosur.

LEXO EDHE:
Kthyen lokalet në sallë lojërash fati, arrestohet administratori në Tiranë, një tjetër në kërkim! 4 në hetim

Ai dyshohet se ka përfituar nga mungesa e vëmendjes së efektivëve dhe e ka fshehur, duke iu shmangur kështu edhe akuzës për "armëmbajtje pa leje". Akoma nuk dihet sesa kohë ka patur arma e fshehur brenda makinës së policisë ndaj hetuesit nuk kanë akoma ndonjë emër të dyshuar. Hetimet po ndiqen edhe nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak se arma është gjetur nga policë.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: pistolete arme policia e tiranes

Komente

Or tej: 21/09/2023 11:26

Kjo duket si barcalete or teeeejjjj

Polici: 21/09/2023 11:18

Gjejeni jepini kafe që jua fali jetën Hajde Polici Hajde; një Çike i shtrëngoi Ministri për të treguar që jam për punën !? Shiko sa skandale në polici shumica në shërbimë të krimit ata që mundohen ti dalin kundër krimit nuk kanë përgatitjen e duhur, plagosjen rrifen aksidentohen me makina nga krimi, edhe ky rasti i pistoletës tregon Që policët janë të pa trajnur terorikish praktikish nuk e njohin ligjin 108 për policinë e Shtetit,ose hezitojn ta zbatojnë më keq, Po pse këtu policë janë Në dënyrë ,e thjeshtë Rekrutohen me Mk lek dhe mbi baza partie: dhe praktika e punës i Nxjerr hapur: jamë i Bindur që skandale ka më shumë por nuk raportohen psh skandalet seksuale në krye të Detyrës!? Por kjo nuk është me e keqa ,më e keqa është qe tani këto institucionet e siguris nuk po gjejnë dotë me njerëz ,kohët e fundit po rekrutohen me 9 klasë dhe me dy shtetsi mbi moshë pa standarte fizike e psikologjike !? Situat në të Cilën Skandalet do Shtohen

Cfar niveli policie: 21/09/2023 10:57

Edhe sikur ta ket len nje i shoqeruar si e futni ne makin pa e kontrollu ?? Duhet te shkarkoheni nga detyra . Po sikur ai te ju fuste nga nje plumb pas koke ?

Policia qe duam: 21/09/2023 09:51

Bravo, e keni fut ne makine pa e kontrollu, Keshtu ndodh shpesh, jeni 1 ju lumte Ju smendoni as me jeten tuaj jo me te qytetareve, Ju qofshi!!!

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Përplasja për Ukrainën, e drejtoi si duhet Rama KS të OKB?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Zjarri në pallatin 10 katësh në Tiranë referohet ngjarje aksidentale! Policia akoma s'ka ekspertizën për llojin e materialeve të fasadës që u dogj

Sokol Dema

19 Shtator, 11:04

Tiranë/ U kap duke transportuar 12 emigrantë në drejtim të Kukësit, arrestohet 36-vjeçari! Merrte 600 euro për person

19 Shtator, 10:01



Dhuna dhe ndërprerja e ndeshjes Shqipëri - Poloni, policia procedon penalisht 6 tifozët

13 Shtator, 15:04

Qendrat e masazhit fole prostitucioni në Tiranë, arrestohet 30-vjeçarja, në kërkim pronari

13 Shtator, 11:42

E pazakontë në Tiranë! Shoferi lë fëmijën në bagazhin e makinës, gjobitet nga policia (VIDEO)

12 Shtator, 15:28

Hodhën flakadanë dhe ndërprenë ndeshjen në 'Air Albania', policia shoqëron 12 tifozë! Shtatë janë polakë

12 Shtator, 12:41

Sot ndeshja Shqipëri-Poloni në 'Air Albania', rrugët që do bllokohen nga ora 15:00

10 Shtator, 10:11

Tiranë/ Sherr për vendosjen e portës mes dy personave, IMT e heq! Kërcënohen punonjësit, 5 në hetim

10 Shtator, 09:37

Policia shoqëron ekipin e Polonisë në Tiranë, plani i masave për ndeshjen e Kombëtarës! Rrugët që bllokohen në kryeqytet dhe sendet e ndaluara

9 Shtator, 11:15

VIDEO/ 'Më sill 3 pica', 'merr fantat', goditet grupi i shpërndarësve të drogës në lokalet e natës në Tiranë! Drejtohej nga një çift bashkëshortësh

8 Shtator, 08:57

Tiranë/ Ishin bllokuar te shpella e Pëllumbasit, shpëtohen 2 turistë francezë, 5 orë operacion te "Gryka e Skoranës" (VIDEO)

7 Shtator, 11:08

Rrahu bashkëjetuesen dhe kreu marrëdhënie seksuale me 11-vjeçarën, si u zbulua ngjarja në Tiranë! 25 vjeçari i arrestuar, ushtarak

6 Shtator, 13:00

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje